

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
 DIREKTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Datë / Izlaze: Date / Dana: 04 / 08 / 2025

Nr. Orgv. Org. jed. 01	Nr. Prct. Br. Prot. 232	Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
---------------------------	----------------------------	------------------------------

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
 KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
 MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
 E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
 Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me gratë për të diskutuar buxhetimin gjinor

Me datën 24 korrik 2025 është mbajtur dëgjimi i shtatë buxhetor me gratë ferizajase, në kuadër të procesit të hartimit të buxhetit komunal për vitin 2026.

Në këtë takim morën pjesë drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Xhemile Murati-Shabani, si dhe drejtorja e Administratës së Përgjithshme, Agnesa Hajredini.

Drejtorja Murati-Shabani theksoi rëndësinë e këtij takimi për identifikimin e nevojave specifike të grave dhe përfshirjen e tyre aktive në procesin e vendimmarrjes buxhetore.

"Këto takime janë shumë të rëndësishme sepse na ndihmojnë të kuptojmë saktë prioritetet që kanë gratë ferizajase," u shpreh ajo.

Pas fjalës së drejtores, fjala ju kalua të pranishmëve në sallë.

Vlera Shabani-Hendifer

- A ka komuna e Ferizajt, grant specifik për gratë?
- A mund të planifikoni që gjatë vitit 2026 të përkrahën me bursa gratë nga komunitetet në mënyrë që të vazhdohet shkollimi edhe nga ana e tyre.

Kenan Gashi-Avonet

- Në vitin 2026 a keni mundësi të organizoni trajnime specifike për gratë në zonat e thella rurale në mënyrë që të bëhet punësimi i tyre nëpër bizneset ferizajas (bije fjala për kurse të rrobaqepëse).
- Startapet janë të nevojshme për fushën e ndërmarrësisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Gratë të mbështeten edhe me psikolog, sociolog dhe psikiatër dhe këto shërbime të jene falas.
- Të bëhen më shumë thirrje publike për shërbimet sociale
- Të ketë bursa vetëm për gratë në mënyrë që të bëhet shkollimi i tyre.

Ky dëgjim publik ka përfunduar ne orën 11:00.

Procesmbajtëse

Shyhrete Topalli-Rexhepi

Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Ferizajt për vitin 2024